



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.26/2020

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryes, Djellza Hoxha dhe Myjesere Mujku, anëtarë të komisionit, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat _____ si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore në _____ i dyshuar për shkelje të pretenduar disiplinore gjatë marrjes së veprimeve përmbarimore në çështjen përmbarimore P. nr 338/20, pas mbajtjes së seancën dëgjimore publike në të cilën prezentuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj, Fadilete Hoxha, në cilësi të inicuesit të procedurës disiplinore, përfaqësueses së kompanisë _____ dhe përmbaruesit privat, _____ dhe pas seancës për votim dhe këshillim, me datën 25.01.2021, e mori kete:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-26/2020, datë 30.11.2020, dhe ankesa e palës ankuese. Përfaqësuesit të kompanisë _____ datës 09.11.2020, si të pa bazuara.
- II. Organi përmbarues-Përmbaruesi Privat _____ duk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbarimore P. nr 338/20.

Arsyetim

Me datën 09.11.2020, pala ankuese ka paraqitur kundër-përbarim ndaj urdhërit përbarimor në Ministrinë e Drejtësisë në lëndën përbarimore P.nr 338/20 të udhëhequr nga përbaruesi privat [emri i palës], si organ përbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës [emri i nemeiorit]. Pala ankuese pretendon që urdhëri përbarimor është në kundërshtim me ligjin sepse palët kontraktuese ishin marr vesh që *“qiraja vjetore për shfrytëzimin e njësisë me qira është 13,000.00 euro, e cila do të paguhet menjëherë pas nënshkrimit të kontratës dhe në rast se qiramarrësi dështon në përmbushje të obligimit deri me datën 27.01.2020, konsiderohet se qiramarrësi është tërhequr nga kontrata dhe kjo kontratë nuk prodhon efekt juridik.”* Qiramarrësi nuk e ka nënshkruar kontratën në të njëjtën ditë dhe se qiramarrësi nuk e ka shfrytëzuar fare parcelën në fjalë. Sipas ankuesit, përbaruesi privat ka bllokuar llogarinë pa njoftim paraprak të personit autorizues apo pronarit të kompanisë [emri i kompanisë]. Tutje, pala ankuese pretendon se përbaruesi privat nuk i kishte njoftuar për mjetin juridik si dhe kishte përpiluar dy pasqyra në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Përbaruesi privat në përgjigjen e tij me shkrim deklaroi që ka vepruar në pajtim me ligjin dhe autorizimet ligjore. Lidhur me mënyrën e dorëzimit të shkresave, përkatësisht pretendimin e palës ankuese se shkresat e lëndës nuk i janë dorëzuar asnjëherë, përbaruesi privat thekson që, siç edhe shihet nga fletëkthesa e Postës së Kosovës, shkresat e lëndës janë refuzuar për pranim nga ana e debitorit. Lidhur me mungesën e udhëzimit për mjetin juridik të goditjes në urdhërin për përbarim dhe pretendimit për përpilimin e dy pasqyrave dhe kontestimin e dokumentit përbarues, përbaruesi privat thekson që urdhëri përmban udhëzimin ndërsa për sa i përket pasqyrave thekson se njëra ka të bëjë me rastin e refuzimit të përmbushjes së borxhit me këste ndërsa pasqyra e shpenzimeve është dokument i obligueshëm i cili nxirret në fund të procedurës. Përbaruesi, lidhur me kontestimin e dokumentit përbarimor, thekson se për këtë çështje kompetente është gjykata.

Me datën 25.01.2021, Komisioni ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përbarimin Privat, znj, Fadilete Hoxha, në cilësi të inicuesit të procedurës disiplinore, përfaqësuesja e kompanisë [emri i kompanisë], si dhe përbaruesi privat,

Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përbarimin Privat, znj, Fadilete Hoxha, ka bërë shtjellimin e propozimit për fillimin e procedurës penale ndaj përbaruesit privat [emri i palës] duke theksuar se mbetet pranë propozimit. Po ashtu edhe përfaqësuesja e palës ankuese ka ngetur pranë ankesës së paraqitur me shkrim si dhe ka bërë elaborimin e saj. Përbaruesi privat gjithashtu ka paraqitur qëndrimin e tij lidhur me pretendimet e ngritura.

Komisioni Disiplinor, gjatë procedurës së administrimit të provave ka lexuar provat në vijim: Propozimi për përbarim 16.06.2020 si dhe urdhri për përbarim i datës 17.06.2020; aktin noterial me numër LRP 276/2020, i datës 24.01.2020; akti përcjellës për palët dhe organet shtetërore 01.07.2020; pasqyra e shpenzimeve e datës 13.07.2020; komunikimet elektronike të

datës 15.07.2020; certifikata e pronësisë, plani dhe skica, dhe fletëkthesa nga Posta e Kosovës e datës 19.06.2020.

Komisioni me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se i përmbartuesi privat nuk ka kryer veprë disiplinore.

Komisioni gjen me rëndësi të theksoj fillimisht se pala ankuese ka emërtuar aktin me të cilin ka inicuar procedurën disiplinore "*kundërpërmbartim ndaj urdhërit përmbartimor.*" Pavarësisht se procedura disiplinore pranë Komisionit Disiplinor nuk mund të inicohet me kundërpërmbartim por me ankese, Komisioni Disiplinor konsideron që ky akt në përmbartje është i njëjtë me ankesën dhe rrjedhimisht si i tillë i plotëson kushtet themelore ligjore për trajtim nga ana e Komisionit Disiplinor.

Lidhur me meritat e rastit, Komisioni gjen se përmbartuesi privat kishte vepruar sipas ligjit, kishte ndërmarr veprime për të siguruar adresën e saktë të palës debitore. Saktësisht në adresën e palës ankuese ishin dërguar shkresat e lëndës përkatësisht urdhëri për përmbartim. Në fletëkthesë theksohet që "*marrësi refuzon pranimin.*" Vet pala ankuese kishte shprehur moskujdes për të pranuar shkresat nga zyrtarët e Postës së Kosovës lidhur me dokumentet të cilat ata përpiqeshin t'i dërgonin atij. Informacionet e ofruara nga Posta e Kosovës se pala ankuese "*refuzon me pranuar shkresën*" ishin zyrtare dhe ishin të besueshme. Përmbartuesi privat, _____ kishte ndërmarrë veprimet përmbartimore vetëm pasi gjitha përpjekjet e tij për dërgimin e shkresave kishin rezultuar të pasukseshme. Prandaj, Komisioni gjen se veprimet e përmbartuesit ishin plotësisht në pajtim me ligjin.

Për sa i përket udhëzimit për mjet juridik, Komisioni gjen se urdhri përmbartimor përmban udhëzimin juridik. Në fakt, pala ankuese ka inicuar procedurën e kundërpërmbartimit në gjykatën kompetente. Fakti se pala ankuese ka inicuar procedurën kundërpërmbartimore është indikacion se është njoftuar me mjetet juridike në dispozicion për të adresuar pretendimet e saj në gjykatë. Për sa i përket kontestimit të dokumentit përmbartimor, siç është theksuar edhe në vendimet e tjera të këtij Komisioni Disiplinor, kompetente për trajtimin e pretendimeve- përkatësisht kontestimin e dokumentit përmbartues, janë gjykatat. Neni 5 par 5 të LPP lidhur me nenin 71 të LPP shprehimisht parasheh shkaqet juridike për paraqitjen e prapësimin, ku mes tjerash parasheh që palët mund të ushtrojnë prapësim nëse "*dokumenti, në bazë të cilin është marr vendimi përmbartues ose urdhri përmbartues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbartueshmërisë*". Procedurat disiplinore pranë këtij Komisioni nuk janë procedura shtesë të procedurave gjyqësore apo zëvendësuese të tyre ku palët adresojnë përsëri pretendimet ligjore për të cilat vendos gjykata. Kurse sa i përket pasqyrave, njëra kishte të bëjë me rastin e refuzimit të përmbartjes së borxhit nga debitori me këste ndërsa pasqyra e shpenzimeve është nxjerr në fund të procedurës përmbartimore.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.nr 26/2020, datë 25.01.2021



Kryesues i Komisionit Disiplinor
Adnan ISUFI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt-administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.